

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
POGRADEC

NR. 00236-254 REGJ.THEM
Dt. Regj 29.06.2018

NR. (638)-227 VENDIMI
Data 10.07.2018 VENDIMI

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec e përbërë prej:
GJYQTARE: {xxx}

asistuar prej sekretares gjyqësore **znj.** {xxx} sot më datë **10.07.2018**, me pjesëmarrjen e **Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec** përfaqësuar nga prokurori **Znj/Z.** {xxx} mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale Nr. 00236-254 **Regj.Them**, në ngarkim të :

KËRKUES: **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec,**
TË HETUAR: përfaqësuar nga prokurori Z. {xxx} .

{xxx} , i biri {xxx} dhe {xxx} , i datëlindjes {xxx} lindur e banues Pogradec lagja nr. 5, Rr."Islam Dani", banesë private, nr.32, arsimi i mesëm, i martuar me fëmijë, i pa dënuar, i vetëpunësuar, shtetësia shqiptare, identifikuar me kartë identiteti Nr. {xxx} .

{xxx} , i biri {xxx} dhe {xxx} i dtlindjes {xxx} me adresë banimi në lagjen nr.3, Rruga "Reshit Çollaku", banesa nr. 30 private, arsimi 8 klasë, i martuar me femijë, i pa dënuar, i vetëpunësuar, shtetësia shqiptare, identifikuar me kartë identiteti nr. {xxx} .

OBJEKTI:

Pushimin e çështjes penale **nr.131, viti 2017**, për veprën penale të "*Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE:

Neni neneve 328, pika 1, shkronja "d", 329/a dhe 329/b të Kodit të Procedurës Penale

*

Në përfundim të gjykimit zhvilluar në prani të prokurorit {xxx}, në prani të mbrojtësit të personave nën hetim {xxx} dhe {xxx} , Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes dhe çmoi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra në

seancë gjyqësore nënshtruar rregullave të gjykimit të seancës paraprake dhe dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët, në të cilën u kërkua:

Prokuroria: Pranimin e kërkesës. Pushimin e çështjes penale **nr.131, viti 2017**, për veprën penale të “*Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal

VËREN:

I. Procedura.

1. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec është paraqitur kërkesa penale me objekt: “*Pushimin e çështjes penale nr.131, viti 2017, për veprën penale të “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.”

2. Përpara shqyrtimit të kërkesës, Gjykata merr kryesisht (*proprio motu*) në shqyrtim faktin nëse ka apo jo juridiksion gjyqësor penal dhe nëse është apo jo kompetente nga pikëpamja e kompetencës lëndore dhe tokësore në shqyrtimin e kësaj çështje.

3. Juridiksioni gjyqësor penal përcaktohet *inter alia* në nenin 69 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë përcakton se: “*Juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë Kod*”. Bazuar në këtë dispozitë procedurale si dhe duke patur parasysh ndarjen e juridiksionit gjyqësor, në atë civil dhe penal, kjo Gjykatë konstaton se ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes penale objekt gjykimi.

4. Në lidhje me përcaktimin e kompetencës lëndore në shqyrtimin e kësaj çështje, Gjykata referon në nenin 74 dhe 76 të K.Pr.Penale, dispozita në të cilat përcaktohet kompetenca lëndore dhe tokësore e gjykatës. Në interpretim të këtyre dispozitave ligjore, gjykata vlerëson se kjo çështje bën pjesë në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

5. Në përcaktimin e kompetencës lëndore, Gjykata mban parasysh edhe parashikimin e nenit 13/2 pika “ç” të K.Pr.Penale i cili parashikon se: “*Gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykojnë me një gjyqtar ...c) kërkesën e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes për krime...*”, të interpretuar konform jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese e cila është shprehur se: “*...frazë “gjykatë... e caktuar me ligj” në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete*”. (**shiko Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 18.05.2005; nr. 14, datë 17.04.2007**). Nisur nga parashikimi ligjor i mësipërm, kjo çështje u gjykua me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, duke përmbushur kriterin e një gjykatë të caktuar me ligj.

6. Nga aktet e ndodhura në fashikullin e gjykimit rezultoi se nga hetimet e kryera nuk rezultoi e provuar vepra si e tillë.

7. Në seancë paraprake, u paraqiten personat nën hetim të identifikuar sipas organit të akuzës.

II. Rrethanat e faktit.

8. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka regjistruar procedimin 131, **të filluar në datën** 04.05.2017, për veprën penale të “*Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

9. Nga hetimet e kryera për këtë procedim penal ka rezultuar se: Nga studimi i materialit hetimor rezultoi se shtetasit {xxx} dhe {xxx}, të cilët kanë raporte gjinie (vëllezër) për periudhën 2008-2016 kanë kryer një numër transaksionesh bankare të tipit derdhje, tërheqje,

pagesa në favor të personave të ndryshëm.

9.1 Shtetasi {xxx} rezulton të jetë i regjistruar në organet tatimore si person fizik me Nipt :K33714652N1 me datë regjistrimi 01.01.2000 me objekt “tregtim artikuj te ndryshem” ndersa shtetasi {xxx} rezulton te jete regjistruar ne organet tatimore si person fizik me Nipt :K63817624G4 me date regjistrimi 15.02.2006 me objekt “piceri”.

9.2 Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë rezulton se shtetasi {xxx} ka të regjistruar pasurinë me nr. 2/144, ZK 8582. në qytetin e Pogradecit me sipërfaqe 184 m2 truall dhe 125 m2 ndertese (te blere ne dt.12.05.2004 nga i ati Lvtfi Mancellari) ndersa shtetasi {xxx} ka të regjistruar pasurinë me nr.6/198. ZK 8582 në qytetin e Pogradecit me sipërfaqe 203 m2 truall dhe 96 m2 ndërtesë (të regjistruar me dt.10.05.2010 me kontratë kembimi') si dhe pasuritë me nr.5/82. 5/74 dhe 5/80 të ndodhura në ZK 8581 në qytetin e Pogradecit me sipërfaqe respektive 74.8 m2., 20.10 m2. 110.50 m2 qe jane regjistruar ne 11.05.2017 ne zbatim te vendimit gjyqsor nr.360-123 dt 25.05.2016 dhe nr.508-155 dt.19.07.2016 te Gi.Rr.Gi Pogradec si pasuri te hipotekuara.

9.3 Nga informacioni i përcjellë nga D.R.SH.T.RR Korçë rezulton se shtetasi {xxx} ka në pronësi automjetin me targë {xxx} ndërsa shtetasi {xxx} ka në pronësi automjetin me targë {xxx}

9.4 Nga analiza e informacionit të përcjellë nga bankat e nivelit të dytë të cilat operojnë në vëndin tonë rezultojnë këto trasaksione ndër vite:

- në emër të shtetasit {xxx} në datë 1.12.2015 janë derdhur në Credins Bank

1.800.0 lekë të ardhura nga Banka ProCredit dhe që janë kaluar në depozitë; në datën

02.12.2015 janë shtuar dhe {xxx} lekë të terhequra nga një bankë tjetër; në datën

14.04.2016 është tërhequr shuma totale prej {xxx} lekë; në datë 10.03.2017 janë derdhur në Credins Bank 28.000euro “kursime familjare”, të cilat janë tërhequr në vazhdimësi deri në 28.03.2017; në datë 28.03.2017 kanë kaluar në Credins Bank në formën “urdhër xhirim i brendshëm” shuma {xxx} leke, nga të cilat me datën 26.05.2017 janë tërhequr {xxx} lekë dhe ka mbetur gjendje në depozitë shuma {xxx} lekë.

-në emër të shtetasit {xxx} në datë 07.06.2006 janë derdhur në Raiffeisen Bank shuma monetare {xxx} lekë të vendosura në llogari depozitë me afat tre mujor, llogari të cilën e ka mbyllur në datën 11.02.2011 me gjendje 0 lekë.

-shtetasi {xxx} rezulton të ketë marrë kredi në ProCredit Bank në datën

07.01.2014 shumën monetare {xxx} lekë me afat maturimi 12 muaj, e mbyllur në datën 01.12.2014. Po kështu ne Procredit Bank rezulton të ketë patur llogari bankare, ku janë kryer disa depozitime në datën 13.02.2014 shuma monetare {xxx} “kursime”; në datën

23.06.2014 shuma monetare {xxx} “transferta nga një tjetër llogari bankare e shtetasit {xxx}”; në datën 30.09.2014 shuma monetare {xxx} “të ardhura nga shitje e pronës”; në datë 29.12.2014 shuma monetare {xxx} ‘të ardhura nga shitje apartamenti’; në datën 03.02.2015 shuma {xxx} “kësti i dyte i shitjes së apartamentit”; në datën

04.05.2015 shuma {xxx} “kalim për blerje apartamenti nga {xxx}”; në datat

22.9.2014, 31.12.2014, 19.6.2015, 10.12.2015 , 16.6.2016 dhe 22.6.2016 rezulton të jetë kredituar në total nga shtetasi {xxx} në shumën {xxx} dollarë. Gjendja e llogarive ne ProCredit Bank është 0 lekë.

-në datën 25.02.2010 në Tirana Bank është kredituar në emër të shtetasit {xxx} shuma {xxx} lekë nga shtetasi {xxx} , e cila është tërhequr në datën 26.02.2010 dhe në datën 07.10.2010 është depozituar shuma {xxx} lekë nga {xxx} që i ka kaluar shtetasit {xxx} dhe në datën 27.07.2011 në këtë llogari është kredituar shuma “1.850.000” e derdhur nga shtetasi {xxx} me përshkrimin “shlyerje detyrimi”, e cila është tërhequr nga {xxx} . Në datën 20.10.2011 dhe 24.10.2011 në llogari janë kredituar shumat {xxx} lekë nga {xxx} “kthim huaje”, e cila është tërhequr nga shtetasi {xxx} në datën 26.10.2011. Në datën 22.12.2011 është kredituar shuma {xxx} lekë me përshkrimin “shitje pasurie”, të cilat janë tërhequr në datën 22.12.2011. Në datën 24.11.2014 është kredituar shuma {xxx} lekë nga {xxx} “revokim kontrate”. Gjendja në këto depozita është 0 lekë.

- në emër të shtetasit {xxx} rezulton të jetë marrë një kredi në datën 29.05.2007 në Societe Generale Albania Bank në shumën 1.{xxx} lekë e mbyllur në datën 17.10.2012; në datën 19.07.2012 është çelur një depozitë elastike në shumën {xxx} që është mbyllur në datën 31.07.2012; në datën 03.11.2015 është çelur një llogari rrjedhëse që rezulton me balancë {xxx} lekë.

-në emër të shtetasit {xxx} rezulton të jetë kredituar në llogarinë e tij në Raiffeisen Bank në datën 25.03.2014 shuma {xxx} lekë me përshkrimin “likuidim për blerje apartamenti nga {xxx} ”; në datën 26.12.2014 është kredituar shuma {xxx} lekë me përshkrim “derdhje nga {xxx} për shitje apartamenti”; në datën 15.07.2016 është kredituar shuma 2.082.000 me përshkrim “shlyerje detyrimi”; në datën 27.02.2014 është çelur llogaria në euro në shumën {xxx} e transferuar nga llogaria e këtij shtetasi në Tirana Bank dhe e kthyer në valutë USD të tërhequra gradualisht. Gjendja në këto llogari bankare rezulton {xxx} lekë, {xxx} euro dhe {xxx} usd.

-në emër të shtetasit {xxx} rezulton të jetë kredituar në Procredit Bank në datën 21.11.2011 shuma {xxx} euro me përshkrim “blerje prone nga {xxx} ” që është tërhequr dhe gjendja është zero.

-në emër të shtetasit {xxx} rezulton të jetë kredituar në Union Bank në datën

17.11.2015 shuma 3.215.000 lekë me përshkrim “blerje prone nga {xxx} etj” që është tërhequr.

-në Tirana Bank rezulton të jetë celur prej vitit 2007 llogari bankare, ku janë kryer veprime të tilla si: në datën 11.01.2007 është kredituar shuma {xxx} nga shtetasi {xxx} me përshkrim “likuidim detyrimi”; në datën 09.05.2007 është kredituar shuma {xxx} lekë, e cila i është kaluar shtetasit {xxx} ; të njëjtit shtetas i kanë kaluar shumat {xxx} në datën 10.09.2007 dhe {xxx} në datën 14.05.2007 ndërsa në datën 25.06.2007 shtetasd {xxx} i ka kredituar shumën {xxx} lekë me përshkrimin “likuidim detyrimi”; në datën 08.08.2007 i ka kaluar shtetasit {xxx} shumën {xxx} lekë; në datën

09.11.2007 shumën {xxx} lekë; në datën 04.03.2008 shumën {xxx} lekë; në datën

16.12.2008 i është kredituar shuma {xxx} lekë nga shtetasi {xxx} me përshkrimin “huamarrje për arsye biznesi”; në datën 29.12.2008 është kredituar në shumën {xxx} lekë nga shtetasi {xxx} ; në datën 29.02.2008 është kredituar në shumën {xxx} euro me

përshkrimin “{xxx} shlyerje detyrimi për blerje shtëpi”; në datat 02.06.2009 dhe 13.07.2009 e 23.07.2010 është kredituar nga shtetasi {xxx} në shumat {xxx} dhe 500.0 lekë dhe 930.000 lekë me përshkrimin “shlyerje detyrimi”; në datën 03.12.2009 është kredituar nga shtetasi Jorgo Allko në shumën 6.900.000 lekë me përshkrimin “blerje pasurie”; në datat 03.06.2009, 17.06.2009 dhe 19.06.2009 kredituar në shumat 2.000 euro, 20.0 euro dhe 9.000 euro nga shtetasi Edmond Topa; në datën 10.02.2011 është kredituar në shumën {xxx} lekë me përshkrim “shitje pasurie”; në datën 18.03.2011 është kredituar në shumën 1.{xxx} nga shtetasi Dorjan Mançellari me përshkrimin “kthim huaje”; në datën 01.04.2011,05.09.2011, 18.11.2011,24.11.2011 është kredituar nga shtetasi {xxx} në shumën {xxx} ,{xxx} ,{xxx} dhe 2.{xxx} me përshkrimin “kthim borxhi”; në datën 17.11.2011 është kredituar nga {xxx} shpk në shumat {xxx} dhe {xxx} euro me përshkrimin “likudim për blerje trualli”; në datën 02.12.2011 është kredituar në shumën 18.0 euro me përshkrimin “shitje prone”; në datën 01.03.2012 është kredituar në shumën 29.0 euro për përshkrimin “shitje prone”; në datën 18.06.2012 është kredituar në shumën 27.500 euro me përshkrimin “ nga huadhëniet”; në datat 01.03.2012 dhe 23.04.2012 janë kredituar shumat 1.245.000 dhe 2.200.000 lekë me përshkrimin“ nga huadhëniet”; në datën 15.06.2012 është kredituar në shumën 4.650.000 lekë nga shtetasi {xxx} me përshkrimin “dhënie borxhi”; në datat 21.06.2012 dhe 15.08.2012 është kredituar nga shtetasi {xxx} në shumat 3.700 dhe 14.900 dollarë me përshkrimin “kthim huaje”; në datën 03.07.2012 është kredituar në Shumën {xxx} lekë me përshkrimin “nga huadhëniet”; në datën 10.01.2013 është kredituar në shumën {xxx}euro përshkrimin “kthim huaje”; në datën 01.08.2013 është kredituar në shumën {xxx} lekë me përshkrimin “shitje prone”; në datën 14.08.2013 është kredituar në shumën 17.000 euro me përshkrimin “shitje apartamenti”; në datën 27.08.2013 është kredituar në shumën 32.000 euro me përshkrimin “shitje prone”; në datën 16.09.2013 është kredituar në shumën 20.000 euro me përshkrimin “këst nga shitja e pasurisë”; në datën 30.12.2013 është kredituar në shumën 1.476.000 lekë nga {xxx} shpk me përshkrimin “likudim për blerje trualli”; në datën 26.03.2015 është kredituar në shumën 13.500 euro me përshkrimin “kthim huaje”; në datën 26.10.2016 është kredituar në shumën {xxx}euro me përshkrimin “kthim huaje”; Gjendja e depozites në euro është 136 ndërsa në valutën lekë dhe usd është zero.

9.5 I pyetur në cilësinë e personit që ka dijani për veprën penale shtetasi {xxx} ka deklaruar se prej vitit 1994 deri në vitin 1997 ka punuar pa shkeputje si emigrant në shtetin grek dhe nga fundi i vitit 1997 deri në vitin 2000 ka emigruar me shkeputje në shtetin grek. Ai deklaroi se në shtetin grek ka qenë së bashku me të atin dhe vëllezërit të tij dhe ka mundur të grumbullojë të ardhura të mjaftueshme nga emigracioni rreth {xxx}lekë. Në vitin 2004 ka blerë banesën ku jeton aktualisht në shumën {xxx} lekë. Në vitin 2007 ka blerë nga shtetasi {xxx} një sipërfaqe toke dhe objekt në shumën rreth 8.000.000 lekë dhe në vitin 2011 për këtë pasuri ka lidhur një kontratë sipërmarrje me shtetasin {xxx}, administratorin e subjektit {xxx} shpk që ka ndërtuar një objekt shumëkatesh edhe në pronën e tij. Nga kjo marrëveshje ai ka përfituar 5- apartamente dhe shumën 100.000 euro, të cilat gjysëm e vlerës i ka marrë “cash” ndërsa pjesa tjetër i ka kaluar nëpërmjet llogarisë së tij bankare. Ai deklaroi se apartamentet ia ka shitur shtetasve {xxx}, {xxx}, {xxx}, {xxx}dhe {xxx} , nga të cilat ka përfituar rreth 190.000 euro. Ai deklaroi se pasi është kthyer nga shteti grek ka bashkëpunuar në formë ortakerie me shtetasin {xxx}në aktivitetin e varkave për shëtitjen e turistëve. Nga ky aktivitet shtetasi {xxx}i detyrohej një shumë monetare prej {xxx} lekë, të cilën e

ka marrë në formën e një apartamenti që i është shitur në vitin 2009 nga shtetasi {xxx}, përfaqesues i firmës {xxx}shpk pasi ky i fundit i kishte një detyrim shtetasit {xxx}. Më pas ai ka blerë dhe shitur disa apartamente të tjera si në vitin 2012 ka blerë apartament nga shtetasi {xxx} dhe me pas ia ka shitur shtetasit {xxx}; në vitin 2014 ka blerë apartament nga {xxx}dhe më pas ia ka shitur shtetasit {xxx}. Ai deklaron se ka patur disa raste kur personave me të cilët ka patur njohje apo raporte shoqërore iu ka dhënë hua shuma të ndryshme monetare, për të cilat kanë nënshkruar kontrata përkatëse noteriale. Këto shuma monetare përgjithësisht i janë kthyer ndërsa në rastet kur huamarresit nuk kanë respektuar detyrimin e kontrates, ai i është drejtuar gjykatës dhe zyrës përmbartimore për ekzekutimin e këtyre kontratave noteriale sikurse ka qenë rasti i shtetasve {xxx} e {xxx}dhe shtetasve {xxx} e {xxx}, në rastin e të cilëve ka përfituar nga procedurat e përmbartimit disa pasuri të paluajtshme: një banesë private me sipërfaqe 68 m2, një dyqan me sipërfaqe 20 m2 dhe tokë me sipërfaqe 100 m2 truall. Ai deklaron se shtetasit {xxx}, me të cilin ka raporte shoqërore i ka dhënë hua shuma të ndryshme monetare për t'i investuar në kompleksin e ndërtuar në Tushemisht Pogradec dhe për këto veprime kanë nënshkruar kontratat përkatëse noteriale, ku janë vënë si garanci kompleksi dhe një sipërfaqe toke. Po kështu i ka dhënë hua edhe shtetasve {xxx}dhe {xxx}, të cilët ushtrojnë aktivitete private në fushën e tregtimit të karburantit dhe hekur/nikelit, shuma të cilat i janë kthyer në mënyrë korrekte. Ai deklaron se nuk është marrë me ndonjë aktivitet të kundërligjshëm dhe për cdo veprim të kryer ka shkuar tek noteri ku kanë nënshkruar kontratat noteriale dhe cdo pagese është kryer nëpërmjet bankës pasi ka dashur të jetë i rregullt para ligjit dhe të mos fshehë asnjë gjë .

9.6 Shtetasi {xxx} ka vënë në dispozicion të hetimit dokumentet e mëposhtme:

- *Kontrate shitblerje nr.2876 rep nr.728 kol datë 12.10.2000 me palë shitës {xxx}dhe blerës {xxx} për pasurinë nr.4/113 -truall dhe ndërtesë me cmim blerje {xxx} leke*
- *Kontratë shitblerje nr.1345 rep nr.263 kol datë 15 prill 2002 me palë shitës {xxx} dhe blerës Nuri Mustafa për pasurinë nr.4/113 + 1-4-ndërtesë me cmim blerje 3.400.000 leke*
- *Kontratë shitblerje nr.704 rep nr.313 kol datë 25.06.2003 me palë shitës {xxx} dhe blerës Gelaldina Velo për pasurinë nr.4/113 +1-12-ndërtesë me cmim blerje 200.000 leke*
- *Kontratë shitblerje nr.4950 rep nr.640 kol datë 18 Dhjetor 2000 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për pasurinë nr. 9/ 104-apartament banimi me*

*

cmim blerje 1.{xxx} leke

- *Kontratë shitblerje nr.3670 rep nr.973 kol datë 04.11.2003 me palë shitës {xxx}dhe blerës {xxx}për pasurinë nr.2/149+3-2-apartament banimi me cmim blerje 200.000 lekë*

- Kontratë shitblerje nr.757 rep nr.320 kol datë 30.06.2003 me palë shitës {xxx}e {xxx} dhe blerës {xxx} për pasurinë nr.9/84 =2-4 apartament banimi me cmim blerje 200.000 lekë
 - Kontratë shitblerje nr.3402 rep nr.886 kol datë 09.10.2003 me palë shitës {xxx}etj dhe blerës {xxx} për pasurinë nr.5/51+2-7 -apartament me cmim blerje {xxx} lekë
 - Kontratë shitblerje nr.2268 rep nr.858 kol datë 06.08.2004 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx}etj për pasurinë nr.5/51+2-7 -apartament me cmim blerje 200.000 lekë
 - Kontratë shitblerje nr.387 rep nr.137 kol datë 06.02.2004 me palë shitës {xxx}dhe blerës {xxx} për pasurinë nr. 11/126+1-8 -apartament me cmim blerje 200.000 lekë
 - Kontratë shitblerje nr.19 rep nr.19 kol datë 26 janar 2009 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për pasurinë nr.l 1/126+1-8 -apartament me cmim blerje 1.620.000 lekë
 - Kontratë shitblerje nr.13 rep nr.7 kol datë 05.01.2004 me palë shitës {xxx}dhe blerës {xxx} për pasurinë nr.5/308 -ndërtese me cmim blerje {xxx} lekë
 - Kontratë shitblerje nr.280 rep nr.267 kol datë 25.03.2005 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx}truall 200 m2 me cmim blerje {xxx} lekë
 - Kontratë shitblerje nr.590 rep nr.404/1 kol datë 27.02.2006 me palë shitës {xxx}dhe blerës {xxx} për pasurinë nr.l/54-N4 -njësi me cmim blerje 200.0 lekë
 - Kontratë shitblerje nr.09 rep nr.09 kol datë 15 janar 2009 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx}për pasurinë nr.l/54-N4 apartament me cmim blerje 1.190.000 lekë
 - Kontratë shitblerje nr.257 rep nr.207 kol datë 3 Korrik 2006 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për pasurinë nr.9/84+2-4- apartament me cmim blerje 200.000 lekë
 - Kontratë shitblerje nr.3493 rep nr.1233 kol datë 12.11.2004 me palë shitës {xxx}etj dhe blerës {xxx} për pasurinë nr.6/179 -truall 103 m2 me cmim blerje 200.000 lekë
 - Kontratë shitblerje nr.1041 rep nr.937/2 kol datë 02.12.2009 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për pasurinë nr.2/234+1-1- apartament me cmim blerje 6.825.000 lekë
 - Kontratë shitëblerje nr.669 rep nr.424 kol datë 06.11.2011 me palë shitës {xxx} etj dhe blerës {xxx} për pasurinë nr. 1/134-Nl- njësi me cmim blerje 4.076.0 lekë
 - Kontratë shitblerje nr.1931 rep nr.1331 kol datë 23.11.2011 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} etj për pasurinë nr.l/134-Nl- njësi +ne cmim blerje 4.076.000 lekë
- Kontratë shitblerje nr.85 rep nr.39/3 kol datë 15.01.2014 me palë shitës {xxx}etj dhe blerës {xxx} për pasurinë nr. 6/28+1-8- apartament me cmim blerje 3.214.080 lekë
- Kontratë shitblerje nr.1316 rep nr.879 kol datë 27.07.2009 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për pasurinë nr. 2/234+1-1- apartament me cmim blerje 6.825.000 lekë
- Kontratë sipërmarrje nr.297 rep nr.227 kol datë 03.03.2011 me palë porositës {xxx} dhe sipërmarres shoqëria {xxx}shpkpër sipërfaqen e truallit prej 245.5 m2 nga kjo 112 m2 ndertesë
- Deklaratë noteriale datë 07.10.2011 me deklarues {xxx} dhe shtetasi {xxx} për prishjen e kontratës se sipërmarrjes
- Kontratë shitje nr.1421 rep nr.1201/3 kol datë 13.10.2011 me palë shitës {xxx} dhe blerës Shoqëria {xxx} shpk për sipërfaqen e truallit prej 245.5 m2 nga kjo 112 m2 ndertesë
- Kontratë sipërmarrje nr.1443 rep nr.1218/1 kol datë 17.10.2011 me palë porositës {xxx} dhe investitor {xxx}
- Deklaratë noteriale datë 17.10.2011 e shtetasit Kastriot Mancellari
- Prokurë e posacme dçitë 08.01.2013 e shtetasit {xxx}

Kontratë shitje nr.227 rep nr.63 kol datë 26.06.2013 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për pasurinë nr. 4/111+1-4- apartament me cmim blerje 4.050.000 lekë

Kontratë kapari datë 09.01.2013 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për pasurinë apartament me cmim blerje 30.000 euro

Kontratë shitje nr.1590 rep nr.561 kol datë 05.11.2013 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për pcisurinë nr. 1/427+1-68- apartament me cmim blerje 3.330.000 lekë

Kontratë shitje nr.543 rep nr.172 kol datë 01.08.2013 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për pasurinë nr. 1/427+1-69- apartament me cmim blerje 4.0{xxx} lekë

Kontratë shitje nr.427 rep nr.224 kol datë 25.03.2014 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për pasurine nr. 1/427+1-70- apartament me cmim blerje 3.650.000 lekë

Kontrata huaje nr.861 rep nr.466/1 kol datë 12.06.2014 ndërmjet subjekteve “{xxx} dhe “{xxx}”

Kontrata huaje dhe hipotekimi nr.573 rep nr.292/3 kol datë 17.04.2014 ndërmjet palëve hipotekues {xxx} dhe përfitues i hipotekimit {xxx} për pasurinë 2/10 ⁴

Kontrata huaje dhe hipotekimi nr.573 rep nr.293/3 kol datë 17.04.2014 ndërmjet palëve hipotekues {xxx} dhe përfitues i hipotekimit {xxx} për pasurinë 2/12

Kontrata huaje dhe hipotekimi nr.496 rep nr.167/3 kol datë 11.02.2015 ndërmjet palëve hipotekues {xxx} dhe përfitues i hipotekimit {xxx} për pasurinë 2/9

- *Kontrata huaje dhe hipotekimi nr.2302 rep nr.1090 kol datë 13.11.2015 ndërmjet palëve hipotekues {xxx} dhe përfitues i hipotekimit {xxx} për pasurinë 2/8*
- *Kontrata huaje dhe hipotekimi nr.529 rep nr.250 kol datë 11.03.2016 ndërmjet palëve hipotekues {xxx} dhe përfitues i hipotekimit {xxx} për pasurinë 2/27*
- *Kontrata huaje dhe hipotekimi nr.1750 rep nr.1010 kol datë 28.09.2016 ndërmjet palëve hipotekues {xxx} dhe përfitues i hipotekimit {xxx} për pasurinë 2/29*
- *Kontrate shitje datë 02.07.2003 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për automjetin me cmim blerje {xxx} lekë*
- *Kontratë shitje nr.731 rep nr.230 kol datë 30.03.2005 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për automjetin me cmim blerje {xxx} lekë*
- *Kontratë shitje datë 26.04.2011 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për automjetin me cmim blerje 20.000 euro*
- *Kontratë shitje datë 20.01.2014 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për automjetin me cmim blerje 280.000 lekë*
- *Kontratë shitje datë 15.04.2014 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për automjetin me cmim blerje 3.{xxx} lekë*
- *Kontratë shitje datë 17.05.2014 me palë shitës {xxx} dhe blerës {xxx} për automjetin me cmim blerje 700.000 lekë*

9.7 I pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasi {xxx} ka deklaruar se prej vitit 1991 deri në vitin 2000 ka qenë emigrant në shtetin grek. Në vitin 2000 është kthyer në shtetin shqiptar dhe ka blerë nga i ati i tij në shumën 2.100.000 lekë banesën ku jeton aktualisht. Kjo banesë është tre kateshe, kati i parë është përshtatur si piceri, në katin e dytë banon vetë ndërsa katin e tretë e ka përshtatur në disa apartamente që i lëshon me qera në sezonin e verës. Ai deklaroi se nga viti 2006 deri në vitin 2014 ambjentin e katit të dytë e ka punuar vetë si "bar piceri" dhe ka qenë i regjistruar edhe në organet kompetente si person fizik ndërsa më pas e ka lëshuar me qera. Ai deklaroi se në vitin 2009 i ka dhënë hua shtetasit {xxx} shumën monetare 9.000.000 lekë pasi {xxx} që kishte një firmë ndërtimi ia ka kërkuar duke qenë se i nevojitej për të kryer investime në ndërtimin e një objekti shumëkatesh në vendin e quajtur "Turizmi i vjetër". Në kontratën e huasë ishte parashikuar që në rast moskthimi të kësaj shume monetare nga shtetasi {xxx}, në favorin e {xxx} do të kalonin një magazine me sipërfaqe 110 m² dhe një dyqan me sipërfaqe 35 m² të ndodhura në objektin që po ndërtohej. Si rrjedhojë ai i ka shitur këto dy pasuri që ka përfituar nga shtetasi {xxx}. Ai deklaroi se shtetasit {xxx} është sipërmarres në fushën e ndërtimit, i ka dhënë disa herë hua shuma të ndryshme monetare rreth {xxx}lekë dhe për garantimin e kthimit të kësaj shume {xxx} kishte vënë si garanci tre apartamente. Për shkak se {xxx} nuk e ka kthyer shumën monetare të marrë.hua ai ka marre tre apartamentet që ua ka shitur shtetasve {xxx}në shumën

35.0 dollarë dhe {xxx} në shumën 6.000.000 lekë. Po kështu iu ka dhënë hua shuma të ndryshme monetare shtetasve {xxx},{xxx} dhe {xxx}, të cilët i kanë kthyer brenda afatit të parashikuar në kontratat noteriale.

9.8 Shtetasi {xxx} ka vënë në dispozicion të hetimit dokumentet e mëposhtme:

- Kontratë shitblerje nr.1425 rep nr.519 kol datë 12.05.2004 me palë shitës {xxx}dhe blerës {xxx} për pasurinë nr.2/144 -truall dhe ndërtesë 3 katë me cmim blerje 200.000 lekë
- Kontratë qeraje nr.2796 rep nr.740 kol datë 08.08.2003 me palë qiradhënës {xxx} dhe qeramarrës {xxx}për katin e parë e të dytë të ndërtesës për një periudhë tre vjecare me qira mujore 65.000 lekë
- Kontratë sipërmarrje nr.653 rep nr.343 kol datë 04.04.2008 me palë porositës {xxx} dhe sipërmarrës shoqëria {xxx}shpk
- Kontratë sipërmarrje nr.88 rep nr.24 kol datë 14.01.2011 me palë porositës {xxx} dhe sipërmarrës shoqëria {xxx}shpk
- Kontratë porosie nr.2559 rep nr.2509 kol datë 07 Dhjetor 2012 me palë shoqëria {xxx} shpk dhe shtetasi {xxx}
- Kontratë porosie nr.1612 rep nr.1312 kol datë 19.11.2013 me palë shoqëria {xxx}shpk dhe shtetasi {xxx}
- Kontratë porosie nr.161 rep nr.91 kol datë 05.02.2014 me palë shoqëria “Arbona” shpk dhe shtetasi {xxx}
- Kontratë porosie nr.206 rep nr.117 kol datë 12.02.2014 me palë shoqëria “Arbona” shpk dhe shtetasi {xxx}
- Kontratëporosie nr.1201 rep nr.688 kol datë 11.09.2014 mepale shoqëria “Arbona” shpk dhe shtetasi {xxx}
- Kontrateporosie nr.1503 rep nr.879 kol date 14.11.2014 mepalë shoqëria “Arbona” shpk dhe shtetasi {xxx}
- Kontratë porosie nr. 1237 rep nr.659 kol datë 07.08.2014 me palë shoqëria {xxx}shpk dhe shtetasi {xxx}
- Kontrate kalim te drejtash date 04.05.2015 me pale shoqëria “Arbona” shpk dhe shtetasi {xxx}
- Kontratë sipërmarrje nr.690 rep nr.339 kol datë 04.04.2016 me palë porositës {xxx} dhe sipërmarrës shoqëria “Infinit ” shpk
- Deklaratë noteriale datë 20.06.2016 për shlyrje detyrimi me palë shtetasit {xxx} dhe Luan Kapri
- Kontrata huaje nr.1535 rep nr.246 kol datë 15.04.2016 ndërmjet subjekteve “{xxx} dhe “{xxx}”
- Kontrata për kalim të drejtash datë 26.09.2014 me palë {xxx} dhe Kelvin Tona për apartamentin me vlerën 4.{xxx} lekë
- Kontratë kcilim të drejtash datë 24.08.2012 me palë shoqëria KREK” shpk dhe * shtetasi {xxx} e Nexhat Elmasllari
- Prokurë e posacme datë 11.08.2017 e shtetasit {xxx}
- Deklarate noteriale datë 10.03.2017 e shtetasve {xxx} dhe {xxx}
- Ekstrakt historik regjistrimi i subjektit {xxx} -person fizik

10.Nga ana e organit të procedimit janë kryer veprime hetimore sikurse rezulton nga

fashikulli i hetimit, 4 fashikuj gjithësej”.

11. Për sa më sipër, në datën 29.06.2018, nga ana e organit të akuzës, është paraqitur përpara kësaj gjykate, kërkesa objekt gjykimi, me lëndë: “*Pushimin e çështjes penale në lidhje me këtë procedim*” dhe i është kërkuar Gjyqtarit të seancës paraprake pranimit i saj sipas objektit.

III. Vlerësimi i Gjykatës.

12. Neni 199/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: “*Profo/rorz'a ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit* \ Nga përmbajtja e kësaj dispozite rrjedh se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit. Një nga funksionet kryesore të shtetit të së drejtës është respektimi i kuadrit normativ nëpërmjet sigurimit të një drejtësie penale funksionale. Përcaktimi sa më i saktë i detyrave që ka secili aktor në procesin penal është një nga kërkesat kryesore që duhet të plotësojë kuadri kushtetues dhe ligjor në një shtet të së drejtës. Ndjekja penale që zhvillohet mbi bazën e akuzës publike duhet të jetë e mbështetur në dispozita ligjore të përcaktuara saktë, me qëllim dhënien nga gjykata të një vendimi të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm, duke garantuar mbrojtjen e individit nga arbitrariteti dhe shpërdorimi i pushtetit shtetëror. Ky detyrim i shtetit rrjedh nga fakti se ai është garanti i të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe si i tillë duhet të parashikojë të gjithë mekanizmat e nevojshëm dhe procedurat konkrete për funksionimin e tyre, me qëllim dhënien e drejtësisë sipas kritereve të përcaktuara qartë dhe në mënyrë sa më të detajuar¹.

13. Për këtë qëllim, ligjvënësi ka parashikuar ngritjen e një organi të posaçëm për ushtrimin e ndjekjes penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Organi i prokurorisë është një nga mekanizmat e domosdoshëm që ndihmon në dhënien e drejtësisë penale. Ky organ i specializuar ka si funksion kryesor ushtrimin e ndjekjes penale në emër të shtetit dhe përfaqësimin e akuzës publike në gjyq. Ligji procedural penal parashikon të gjitha fazat e hetimit paraprak që duhet të kryhen nga prokuroria, me qëllim vënien para përgjegjësisë të personave që dyshohen si autorë të veprave penale. Me qëllim që prokurori të arrijë të ngrejë akuzë kundër këtyre subjekteve, ai duhet të mbledhë fakte dhe prova me anë të të cilave, në tërësinë e tyre, të mund të arrijë të provojë para gjykatës fajësinë e personit që akuzohet. Nisur nga parimi i ligjshmërisë, prokuroria është e detyruar të hetojë me hollësi dhe të mbledhë prova, nëse ka, kundër çdo të dyshuari.” Akuzë është procedimi penal i një personi, ndaj të cilit bien dyshime si autor i kryerjes së një veprë penale, të parashikuar si të tillë nga legjislacioni penal³. Ngritja e akuzës publike nga prokurori konsiderohet si hapi i parë i ndjekjes penale të personit të dyshuar.

13.1. Ndjekja penale nënkupton kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji me qëllim vërtetimin e akuzës së ngritur nga prokurori. Procedimi i personit të akuzuar për kryerjen e një veprë penale nga organi i ngarkuar me këtë funksion përfshin hetimin e plotë nga organi i akuzës, mbi bazën e të cilit gjykata do të vendosë fajësinë ose pafajësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale⁴. Elementë të këtij procesi janë: caktimi i masave të sigurimit, njoftimi i akuzës dhe pyetja e të pandehurit, kqyrja dhe

¹ Peter Badura, Staatsrecht (1996) fq. 597.

² Shiko Vendimin Nr. 3, datë 06.02.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

³ Barron's Laë Dictionary, Fifth Edition, fq. 8.

⁴ Black's Laë Dictionary, Seventh Edition, fq. 1221.

kontrolli i personit ose i banesës, sekuestrime, marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe mbledhja e provave të tjera³. Të gjitha këto hapa kryhen nën drejtimin dhe përgjegjësinë ekskluzive të prokurorit, i cili që në momentin që vihet në dijeni të veprës penale, kryen çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm për identifikimin e autorit të kësaj vepre dhe marrjen e tij në përgjegjësi penale.

14. Për të garantuar jo vetëm qenien aktive të organit të prokurorisë në ndjekjen penale dhe dënimin e personave të dyshuar si autorë të veprave penale, por edhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individëve ndaj të cilëve ngrihet akuza ose janë dëmtuar si pasojë e veprës penale konkrete, ligjvënësi ka parashikuar në disa dispozita të K.Pr.Penale mundësinë që palët në proces për çdo veprim që ata mendojnë se cenojnë të drejtat dhe liritë e tyre t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës për kontroll.^{1 2} Në këtë frymë, neni 278 i K.Pr.Penale parashikon se gjatë hetimeve paraprake për rastet e parashikuara nga ligji mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit dhe të dëmtuarit vendos gjykata. Kjo dispozitë është miratuar nga ligjvënësi në vitin 2002, në kuadër të një koordinimi sa më të mirë të dispozitave që u japin palëve gjatë procesit të hetimeve paraprake disa të drejta procedurale. Më tej, në dispozitat e tjera të K.Pr.Penale, janë specifikuar disa nga rastet kur lejohet ankimi gjyqësor i vendimeve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake.

15. Gjithashtu, në nenin 329 të K.Pr.Penale, është parashikuar e drejta e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal gjatë fazës së hetimeve paraprake. Ky kontroll ushtrohet në funksion të parimit të ligjshmërisë së procedimit penal dhe të garantimit të të drejtave të palëve të përfshira në të.^{3 4} Kjo e drejtë për të kundërshtuar veprimet e prokurorit në rrugë gjyqësore, pra për t'iu drejtuar një autoriteti të pavarur dhe paanshëm, është në përputhje edhe me standardet e vendosura nga neni 42 i Kushtetutës. Në parim, ligjvënësi ia ka nënshtuar të gjitha veprimet hetimore paraprake kontrollit gjyqësor. **Praktika njeh dy mënyra për ushtrimin e këtij kontrolli: ose nëpërmjet gjykatës, siç parashikon legjislacioni shqiptar ose nëpërmjet gjyqtarit hetues, i cili, në legjislacionet e disa vendeve, është organi kompetent për të kontrolluar të gjitha veprimet hetimore paraprake para se çështja t'i kalojë për gjykim gjykatës kompetente.**⁸ Legjislatori shqiptar, para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale kishte zgjedhur mënyrën e parë, sipas të cilës i lihej në vlerësim vetë personit të interesuar nëse dëshironte të ankimonte vendimet e prokurorit. Në fund ishte gjykata që kishte të drejtë të shprehej për të gjitha veprimet hetimore përfshirë edhe vendimin e pushimit të çështjes. Gjykata gjatë shqyrtimit të këtij vendimi duhet të konstatonte, nëse prokurori e kishte pushuar çështjen në zbatim të ligjit dhe mbështetur në prova dhe argumente të mjaftueshme apo jo, ose nëse prokurori realisht i kishte bërë të gjitha përpjekjet për të zbuluar faktin, pavarësisht përfundimit ku ka arritur.

16. Në kudër të përmirësimit të legjislacionit dhe përshtatjes së tij me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira, lindi nevoja e harmonizimit të K.Pr.Penale me amendamentet Kushtetuese⁵ dhe ligjet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë, në

¹ Kreu i VII i Kodit të Procedurës Penale të RSh.

² Shiko Vendimin Nr.14, datë 16.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

³ Shiko Vendimet Nr. 7, datë 16.01.2013 dhe Nr. 196, datë 04. 07.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

⁴ Shiko Vendimin Nr. 5, datë 06.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralbuar. 3. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. ”. Pra, sipas kësaj dispozite kushtetuese prokuroria funksiononte në mënyrë të centralizuar. Ndërkohë me ndryshimet që i bënë nenit 148 me me Ligjin Nr. 76 të vitit 2016, parashikohet shprehimisht se: “1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akucën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. 2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj

dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit. 3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë 'sistemit gjyqësor', 4. Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme." Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se prokuroria tashmë nuk është më organ i centralizuar por një organ i decentralizuar dhe prokurorët janë të pavaruar në hetimin dhe ndjekjen penale.

fushën penale, si: Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si dhe ligjet e tjera që janë pjesë e paketës ligjore të reformës në drejtësi. Ndodhur në këto kushte, me Ligjin Nr. 35 të vitit 2017 u bënë ndryshimet në K.Pr.Penale, të cilat hynë në fuqi më datën 1 Gusht 2017. Në mënyrë të veçantë, janë reflektuar në K.Pr.Penale ndryshimet e reja kushtetuese dhe ligjore që lidhen me: a) Kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatës për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (neni 75/a) dhe rregullimin e marrëdhënieve mes Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm (neni 28 dhe 29 K.Pr.Penale); b) Pavarësinë hierarkike të prokurorit të çështjes (shfuqizuar paragrafet 4 dhe 5 të nenit 24 dhe neni 305 K.Pr.Penale mbi marrjen përsipër të hetimeve); c) **Parashikimi i figurës së gjyqtarit të seancës paraprake.**

17. Qëllimi i ligjvënësit në realizimin e ndryshimeve ligjore të mësipërme, identifikohet edhe në relacionin dhe raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut që shoqëroi miratimin e Ligjit Nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhur me gjyqtarin e seancës paraprake thuhet sh'prehimisht: “...*decentralizimi i institucionit të prokurorisë, u shoqërua me nevojën e parashikimit të figurës së gjyqtarit të seancës paraprake për garantimin e kontrollit të veprimtarisë së prokurorit gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe forcimin e gjykimit. Projektligji parashikon figurën e re të gjyqtarit të seancës paraprake, si gjyqtari që kontrollon veprimet dhe vendimmarrjen e prokurorit mbi fatin e çështjes.*”

18. Në lidhje me sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar me Ligjin Nr.35/2017, për herë të parë në historinë e shtetit të së drejtës në Republikën e Shqipërisë, ka parashikuar jo vetëm një subjekt të ri procedural (*gjyqtarin e seancës paraprake*), por edhe një fazë të re të procedimit penal, e ndryshme nga procedimi penal klasik (*faza e hetimit dhe gjykimit*), ajo e seancës paraprake, e cila ka në themel këto elementë:

- (i) Së pari, rritjen e efektivitetit dhe efijencës së ndjekjes penale, sipas parimit të ligjshmërisë.
- (ii) Së dyti, respektimin e së drejtës së personit nën hetim, të pandehurit për një proces të rregullt ligjor (hetimor dhe gjyqësor).
- (iii) Së treti, respektimin e parimit kushtetues të hetimit dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor.
- (iv) Së katërti, respektimin e parimit të ekonomisë gjyqësore.

(v) Së pesti, respektimin dhe garantimin e të drejtave të viktimës në procesin hetimor dhe gjyqësor penal.

(vi) Së gjashti, garantimin e parimit kushtetues, të dhënies së drejtësisë nga gjykata.

19. Gjkata vlerëson se në interpretim historik dhe teleologjik të dispozitave të ndryshuara të K.Pr.Penale, me Ligjin Nr.35/2017, në të cilat është parashikuar rishtazi, figura procedurale e gjyqtarit të seancës paraprake, në kompetencë të të cilit, përfshihen ato kategori çështjesh (*ratione materiae*), të cilat nga pikëpamja kohore (*ratione temporis*) vijnë menjëherë pas përfundimit të hetimeve paraprake, por përpara fazës së gjykimit. Në këto kushte, çështjet që shqyrton gjyqtari i seancës paraprake konsistojnë në mënyrën e përfundimit të veprimtarisë hetimore të prokurorit, i cili pasi ka ushtruar ndjekjen penale, sipas nenit 199 të Kushtetutës dhe sipas neneve 278 e vijues të K.Pr.Penale, mbështetur në parimin e ligjshmërisë, mund f i kërkojë gjyqtarit të seancës paraprake⁶:

(i) .Dërgimin e çështjes në gjykim (*neni 331 i K.Pr.Penale*).

(ii).Pushimin e akuzës ose të procedimit penal, në rastin kur ndodhemi përpara krimeve (*'neni 329/a i K.Pr.Penale*).

20. Në lidhje me sa më sipër, Gjkata vlerëson se në kuadër të kompetencave të gjyqtarit të seancës paraprake, ligjvënësi ka përcaktuar kompetencën e tij, për të shqyrtuar kërkesën e prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes penale kur procedohet për krime dhe kur është një nga rastet e parashikuara nga paragrafi i parë, i nenit 328 të K.Pr.Penale.

21. Referuar kompetencës së mësipërme të parashikuar në ligj, organi i prokurorisë ka paraqitur para gjyqtarit të seancës paraprake një kërkesë me objekt pushimin e procedimit penal **Nr. 323 të vitit 2017**, me arsyetimin dhe ndodhemi në kushtet e parashikimit të nenit 328/1 pika “dh” e K.Pr.Penale.

22. Nga analiza në teresi e fakteve dhe provave të sipercituara rezulton nuk mund të provohet vepra penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

22.1 Ashtu sikurse ka arsvetuar edhe organi i akuzës, për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve të saj të marra së bashku, të cilët janë: *a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive.*

22.3 Neni 287 të Kodit Penal parashikon se: ***“Pastrimi i yprodukteve te veprës penale i kryer nëpërmjet: a) këmbimit ose transferimit te pasurisë, qe dihet se është produkt i veprës penale, për fshehjen ose zhdukjen e origjinës se paligjshme te pasurisë ose dhënien e ndihmës për te shmangur pasojat juridike, qe lidhen me kryerjen e veprës penale; b) fshehjes ose mbulimit te natyrës, burimit, vendndodhjes, vendosjes, zhvendosjes se pronësisë ose te te drejtave te tjera, qe lidhen me pasurinë qe është produkt i veprës penale; c) kryerjes se veprimeve financiare dhe transaksioneve te copezuara për shmangien nga raportimi, sipas ligjit për pastrimin e parave; ç) fitimit, zotërimit ose përdorimit te pasurisë, kur dihet qe është produkt i veprës penale; d) këshillimit, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave te përcaktuara me sipër, dënohen me burgim nga tre deri ne dhjete vjet dhe nie gjobe nga 500 mije leke deri ne 5 milionë leke. 2. Kur kjo vepër kryhet gjate ushtrimit te një veprimtarie profesionale, ne bashkëpunim ose me shume se një liere,***

⁶ Sipas nenit 327/6 të K.Pr.Penale.

dënohet me burgim nga pese deri ne pesëmbëdhjete vjet dhe me gjobe nga 800 mije leke deri ne 8 milionë leke, ndërsa kur ka sjelle pasoja te renda, dënohet me burgim jo me pak se pesëmbëdhjete vjet dhe me gjobe nga 3 milionë leke deri ne 10 milionë leke. 3. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe ne rastet kur personi, qe ka kryer veprën prej se cilës burojnë produktet e veprës penale, nuk mund te merret i pandehur, nuk mund te dënohet, ekziston një shkak qe e e shuan veprën penale ose mungon njeri nga kushtet e procedimit penal për një vepër te tillë

24 Nga analiza e dispozitës së mësipërme rezulton se:

24.1 Vepra penale e “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, është një krim i pavarur, i parashikuar si i tillë nga vetë legji islatori. Pavarësisht se është një vepër penale e pavarur, ajo nënkupton dy komponentë thelbësor: /jKryerjen e një vepre penale të mëparshme, vepër penale “*mëmë*”, nga ana e një subjekti të përgjithshëm ose të posaçëm, e cila është e parashikuar si e tillë nga legjislacioni penal dhe e dënueshme me burg ose gjobë. Kjo vepër përfshin si krimet ashtu edhe kundravajtjet penale, dhe nuk ka ndonjë kufizim nga ana e legjislatorit, për shembull duke u nisur nga dënimi ose rrezikshmeria. Teorikisht të gjitha veprat penale të parashikuara nga legjislacioni penal, konsiderohen vepra “*mëmë*”; z/jKryerjen e një sërë veprimesh të tjera, nga i njëjti subjekt që ka kryer krimin e mëparshëm ose “*mëmë*”, ose ndërhyrja e një ose disa personave të tjerë, për t’i dhënë kësaj pasurie të grumbulluar në mënyrë kriminale, një dukje si legjitime. Personat që ndërhyjnë duhet t’a dinë origjinën e paligjshme dhe kriminale të këtyre produkteve kriminale dhe me vetëdije ndërmarrin hapa për t’i trajtuar këto produkte nëpërmjet mekanizmave kompleks.

24.2 Nga interpretimi i qëllimit të krimit të “Pastrimit të produkteve të veprave penale ose veprimtarisë kriminale” na rezultojnë se: **së pari** duhet të kemi një shtim të pasurisë së autorit që ka kryer veprën pararendëse; **së dyti** shtimi i pasurisë të ketë ardhur në mënyrë të paligjshme nga vepra penale e kryer dhe **së treti** subjekti kërkon që t’i fshehtë ose mbulojë origjinën ose t’i japë atij një aparençë të ligjshme.

24.3 Krimi i “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, në përgjithësi është një vepër penale me karakteristika të qëndrueshme në kohë, duke çënuar marrëdhënie juridike-penale për një kohë të caktuar, në mënyrë të pandërprerë, ku veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm vazhdon pa ndërprerje. Nuk përjashtohet fakti se ky krim mund të realizohet qoftë edhe me përmbushjen e një veprimi ose operacioni të vetëm. Përfitimi i paligjshëm i realizuar nga kryerja e një vepre penale, mund të investohet në një biznes të ligjshëm, kryesisht nga ata që veprojnë me para kesh dhe të përfitohet në moment aparenca e ligjshme. Por zakonisht praktika dhe teoria ka pranuar se kjo vepër është e qëndrueshme dhe e vazhdueshme në kohë. Në të shumtën e rasteve, kjo vepër është komplekse për nga mënyra se si realizohet, kur sjellja artikullohet nëpërmjet një serie operacionesh të lidhura me njëri-tjetrin, mbi të njëjtën sasi parash ose produktesh, për të humbur gjurmët e origjinës së paligjshme dhe që të sigurohet fshehtësia ose mbulimi i origjinës dhe legjitimiteti i tyre. Pra në këtë mënyrë pranojmë se kjo vepër mund të jetë dhe një vepër penale vazhduese, e kryer me dy ose më shumë veprime ose mosveprime të njëllota, në kuadrin e zbatimit të një mendimi të vetëm kriminal. Të gjitha këmbimet, transferimet ose trasaksionet realizohen me qëllimin e fshehtësisë së origjinës, së natyrës, lëvizjes vendodhjes, përkatësisë ose kontrollit mbi këtë pasuri ose produkt, me qëllim për të realizuar legjitimitetin

e saj.

24.4 Nisur nga interpretimi historik i veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, jo vetëm në Shqipëri por më gjerë, do të gjejmë se kjo veprë penale është konsideruar me një rrezikshmëri të theksuar.

24.5 Si fillim, në legjislacionet e huaja është parashikuar si një veprë penale e drejtuar kundër pasurisë dhe pronës dhe më vonë është vërejtur roli dhe ndikimi që ajo luan në ekonominë e një vendi, duke cënuar deri vetë sistemin demokratik të çdo shteti. Nisur nga ky impakt, konsumimi i kësaj vepre penale shihet i ndarë nga vepra penale produktet e të cilës pastron, dhe në vetvete përfaqëson pasoja të tjera, të cilat domosdoshmërisht nuk janë të lidhura vetëm me përfimin e nxjerrë, por më gjerë, duke përfshirë edhe ndikimin në ekonominë e një vendi si dhe rendin e sigurinë e tij. Për këtë shkak është logjike që rrezikshmëria e saj të përshtatet me dënime qoftë edhe më të larta se vepra pararendëse e konsumuar, nga e cila kanë rrjedhur përfitimet e paligjshme.

25 Objekti: Objekti i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar garantimin e funksionimit të rregullt të organeve të administratës publike dhe mbrojtjen e interesit të shtetit dhe shtetasve nga pastrimi i produkteve të veprës penale.

25.1 Vepra penale e “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal, bën pjesë në kreun e krimeve kundër rendit dhe sigurisë publike. Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme, për marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç janë ato të vendosura nga shteti për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, sistemin monetar dhe financiar, interesat e ligjshme të shtetit dhe të shtetasve, të mbrojtura posaçërisht nga ligji penal. Kjo veprë penale drejtohet kundër marrëdhënieve juridike të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal që synojnë funksionimin normal të sistemit ekonomik-financiar, pastërtinë e tij, luftën kundër krimeve në përgjithësi dhe krimin të organizuar në veçanti.

25.2 Objekti material i sjelljeve të veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, janë paratë, të mirat ose të tjera dobi. Nga një interpretim i zgjeruar, i asaj që pohuam më sipër, rezulton se produkte të krimin mund të jenë si paratë, ashtu edhe biznese, shoqëri, titull, metale të çmuara, të drejta kredie. Në një çështje ku ka pasur një akuzë për pastrim produktesh kriminale, të paraqitur përpara Gjykatës së Kasacionit Italiane, kjo e fundit është shprehur në vendimin e datës 12 nëntor 2002 se: “ janë të mira, gjërat që mund përbëjnë objekte të së drejtës...”. Për të përfshirë në objektin material të veprës, çdo entitet ekonomik të vlerësueshëm, duhet të ketë ardhur nga vepra penale dhe të mos kishte ekzistuar para momentit të kryerjes së saj, në kuptim që duhet të bëjë pjesë në pasurinë e subjektit që akuzohet apo që procedohet për këtë veprë penale. Vetëm nëse ajo ka një vlerë të caktuar ekonomike dhe ekzistancë në pasurinë e kryesit të veprës penale, ajo mund të këmbëhet, transferohet, lëvizet, fshihet, apo të jetë objekt trasaksionesh në tregun e* ligjshëm, atë të të mirave. Në këtë mënyrë mund të futet në tregun e parave apo të dobive të ndryshme, të ketë vlerë ekonomike dhe mbi të gjitha që të jetë lirisht e shpenzueshme dhe likuide.

26 Ana Objektive: Ky krim mund të realizohet me një veprim të vetëm ose me shumë veprime të lidhura ndërmjet tyre, që kalojnë në disa faza, që zhvillohen në kohë. Nga pikpamja strukturore e skematike, fenomeni i pastrimit të parave realizohet në tre faza

kryesore" të cilat konsistojnë në vendosjen ose grumbullimin e parave ose produkteve të veprës ose veprave penale, shtresëzimi i tyre, që siç e kemi pranuar dhe më sipër konsiston në lëvizjen e tyre, kryesisht nëpërmjet sistemit bankar dhe faza e tretë ajo e investimit të kapitalit në aktivitete të tjera të ligjshme ose jo. Pavarësisht se të krijohet ideja se grumbullimi i kapitalit, që përbën fazën e parë, paraqet rrezikshmëri të theksuar, në interpretim të kësaj vepre penale rrezikshmëria përcaktohet nga aftësia e subjektit të veprës penale për të kaluar vështirësitë që dalin përpara gjatë gjithë procesit.

26.1 Rrezikshmëria e operacioneve të shtresësimit, konsiston nga ana tjetër, në një numër të madh transaksionesh të njëpasnjëshme, secila prej tyre në tërësinë e procesit, e bën më të vështirë rindërtimin e rrugës për gjurmimin e parave. Investimi përbën fazën finale, ku marrja dijeni mbi këtë veprimtari është e një vështirësie më të lartë, gati e pamundur.

26.2 Duke u nisur nga konteksti i kësaj vepre, është vërejtur konkretisht se të gjitha operacionet e pastrimit, duke filluar nga ato më të fshehtat deri në ato më të rëndësishmet dhe

komplekset, janë të lidhura mes tyre nëpërmjet disa elementëve **Fshehja e pasurisë reale e faktike; Modifikimit të formave të produkteve (ose parave); Fshehja e gjurmëve; Kontrolli konstant mbi produktin e krimit;**

26.3 Për sa i përket anës objektive, për të konsideruar të konsumuar veprën penale duhet të kemi: *këmbim ose transferim të pasurisë, fshehje mbulim të natyrës së vërtetë të burimit vendoshjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave pasurore, fitim të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, kryerje të veprimeve financiare ose trasaksioneve të copëzuara për shmangie nga raportimi sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave, investimi në veprimtari ekonomike ose financiare të parave ose sendeve, ose keshillim, nxitje, ndihme, thirrje publike për kryerjen e njëres prej veprave të sipërcituara.*

26.4 Këmbimi ose transferimi kryhet nëpërmjet transaksioneve financiare, (blerja e një çeku të arketueshëm, këmbimi i një cekit me një tjetër monedhë, ose blerja e një malli të çmuar) ose nëpërmjet transaksioneve jo financiare (lëvizja ose dorëzimi i parave nga një person tek një tjetër). Transaksioni përfshin një blerje, shitje, kredi, premtim, dhuratë, transfertë, dorëzim etj, kur bëhet nga një institut financiar. Ai përfshin instrumente monetare si depozita, transfertat ndërmjet llogarive, këmbim valute, kredi, blerje apo shitje mallrash, çertifikata depozitimi, përdorja e një depozite bankare si dhe çdo pagesë dorëzimi apo transferimi nëpërmjet një instituti financiar, dhe nënkupton përdorimin e institutit financiar i cili merr pjesë në to, aktivitetet e të cilit prekin tregtinë brenda apo jashtë shtetit, në cilëndo mënyrë apo gradë^{7 8 9 10} Transaksionet financiare përfshijnë lëvizjen e fondeve edhe nëpërmjet internetit apo mjeteve të tjera, ose transferimet e titujve të pronësive të paluajtshme, makinave etj.

26.5 Pjesëmarrja në një transaksion mund të kryhet në fillim, pra subjekti e nis transaksionin, mund të zhvillohet apo kryhet me pjesëmarrjen e tij, dhe mund të kryhet duke e përfunduar i pandehuri transaksionin. Pra i pandehuri duhet të ketë pasur në një moment kontrollin mbi këto produkte të kësaj veprimtarie kriminale.^{7 8 9 10}

26.6 Këmbimi, nga kartëmonedha me prerje të madhe, në kartëmonedha me prerje me të

⁸ Tecnica delle inchieste patrimoniali per la lotta alla criminalita organizzata, Nicolo Pollari, Alberto del Cioppo, quinta edizione, LAURUS ROBUFFO, f.888.

⁹ P. GRANATA, *Aspetti finanziari del riciclaggio connessi con iltraffico di sostanze stupefacenti*, Riv. G.d.F., 2003, pp. 1667- 1668.

¹⁰ Vendimi Shtetet e Bashkuara kundër Dvorak, 617 F.3d 1017,1023 (8th Cir. 2010);

vogël ose anasjelltas, mund të përbëjë një skemë pastrimi parash, nëpërmjet strukturimit, duke u nisur nga metoda që ndjek i pandehuri.

26.7 Pastrimit i produkteve të veprës penale, si vepër penale, përfshin veprimet dhe mosveprimet e ndërmarra nga pastruesi për të legjitimuar produktet e një ose disa veprave penale. Konkurrimi i veprave penale me njëra-tjetrën, nuk është një fakt relevant për të përcaktuar ekzistencën ose jo të veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penale. Kjo është një vepër e veçantë e cila qëndron e pavarur nga veprat e tjera “mëmë”, nisur nga mënyra se si kryhet. Qëllimi i saj është legjitimimi i pasurisë së hedhur tashmë në dorë në mënyrë jo të ligjshme, dhe jo mënyra se si mund të jetë fituar kjo.

26.8 Për të provuar dijeninë e subjektit, në disa raste është një sfidë e vërtetë. Termi “*dijeni*” që prona ose pasuria e përfshirë në një transaksion financiar përfaqëson produkte të ndonjë forme veprimtarie kriminale, do të thotë se personi e di që “*prona ose pasuria*” e përfshirë në një transaksion financiar, përfaqëson produkte të ndonjë forme veprimtarie kriminale, pa e specifikuar domosdoshmërisht veprën penale sipas legjislacionit penal të shtetit apo të një shteti tjetër¹¹. Pra sa më sipër, subjekti mban përgjegjësi për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprave penale ose veprimtarisë kriminale”, nëse ai është në dijeni që pasuria që përfshihet në këmbime, transferime, transaksione... është produkt i një vepre penale apo aktiviteti kriminal, pa e specifikuar atë, dhe ai vepron dhe ndërmerr ose tenton të ndërmarrë këto veprime të sipërcituara, të cilat në fakt e përfshijnë këtë produkt të veprës penale apo të aktivitetit të paligjshëm, me qëllim për të kryer një aktivitet tjetër të paligjshëm dhe për të legjitimuar këtë pasuri.

26.9 Jurisprudenca tashmë, e ka krijuar standardin që, ana subjektive e një vepre të kryer nga një i pandehur, mund të rezultojë nga veprimet e anës objektive. Në shumë çështje, dijenija kriminale e të pandehurit ose qëllimi i tij mund të mos provohet me prova direkte, megjithatë një gjë e tillë, rezulton nga rrethanat dhe nga ndërthurja e provave¹² ose i pandehuri ka dijeni të fajshme të faktit, kur provat tregojnë që ky i pandehur me qëllim ka shmangur konfirmimin e faktit¹³. Dijenija mund të rezultojë nga faktet dhe rrethanat që tregojnë që këto produkte nuk mund të justifikoheshin me të ardhurat e deklaruara, që duhet të rridhnin nga një aktivitet i ligjshëm.

26.10 Karakteristika e qënësishme e ekzistencës së veprës penale të parashikuar nga neni 287 i K. Penal, është qëllimi për të legjitimuar pasurinë, duke fshehur mbuluar origjinën e paligjshme;

27. Nga ana e organit të akuzës në rastin konkret është arsyetuar se: “...*Veprapenale kryhet me veprime të kundraligjshme në mënyra të ndryshme si psh: nëpërmjet këmbimit ose transferimit të pasurisë që dihet se është produkt i veprës penale, fshehjes ose mbulimit të natyrës, burimit, vendndodhjes, vendosjes, zhvendosjes së pronësisë ose të të drejtave të tjera - që lidhen me pasurinë që është produkt i veprës penale, kryerjes së veprimeve financiare dhe ‘ transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi sipas ligjit për pastrimin e parave etj. Midis veprimeve të autorit të veprës penale (që synon pastrimin e produktit të veprës penale) dhe pasojës apo mundësisë së ardhjes së saj (pastrimi i produktit të veprës penale)*”

¹¹ Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër Cedeno-Perez, 579 F. 3d 54. 59 (T’Cir. 2009).

¹² & LaFave, Substantive Criminal Laë § 5.2(a), p. 341 (2d ed. 2003).

¹³ Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër Quinones, 635 F.3d 590, 594 (2d Cir. 2011).

duhet të ekzistojë lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme, që do të thotë se pastrimi i produktit të veprës penale (pasoja) duhet të vijë ekskluzivisht dhe drejtpërdrejtë nga veprimet e autorit të veprës penale (shkaku).

Pastrimi i parave është një "proces nëpërmjet të cilit të ardhurat e realizuara me mënyra të kundraligjshme si psh: korrupsion, trafik droge, njerëzish etj investohen apo përdoren në/për veprimtari të ligjshme me qëllim fshehjen e origjinës së tyre. Ky proces përfshin një numër të madh aktivitetesh, qëllimi i vetëm i të cilave është fshehja e origjinës, vendndodhjes, lëvizjes të pasurive të cilat rrjedhin nga veprimtari të kundraligjshme dhe përpjekja që hurimi i tyre të duket se është i ligjshëm. Midis produktit të veprës penale (vepra penale mëmë) dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti (vepra penale bijë) duhet të ekzistojë gjithmonë një lidhje shkakësore e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme (kusht pa të cilin —condicio sine qua non).

Organi i akuzës çmon të sqarojë se që personi të dënohet apo dyshohet për kryerjen e veprës penale të **“Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”** parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal duhet që të plotësohen disa kushte kumulative : e para) të ketë dyshime të arsyeshme dhe më pas prova bindëse se vetë ky person, familjarët apo të afërmit e tij (nuk përjashtohen personat e njohur prej tij si shokë, miq, kolegë, ortakë etj) kryejnë veprimtari të jashtëligjshme si psh; trafik droge, akte korruptive, trafik njerëzish etj nga e cila përfitohen të ardhura; e dyta) personi të disponojë pasuri të luajtshme apo të pa luajtshme të cilat nuk justifikohen nga të ardhurat e tij të cilat janë përfituar duke kryer një punë apo veprimtari të ligjshme, pra personi nuk justifikon pasurinë që posedon pasi ajo nuk përputhet me ato që ai fiton në mënyrë të ligjshme (**raporti midis fitimeve apo të ardhurave/fitimit të pasurisë/pasurive**) është **në përpjestim të zhdrejtë me pasurinë/pasuritë që disponohen**). Teoria e së drejtës penale ka pranuar se për të pasur ekzistencën e elementeve të veprës së **“Pastrimit të produkteve të veprës penale”** duhet medoemos që pasuria e krijuar apo vlera monetare që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie të jetë rrjedhojë e përfitimeve të ardhura nga aktiviteti kriminal i kryer;^{14 15} e treta) të ardhurat e përfituara nga krye'rja e veprimtarive të jashtëligjshme të jenë përdorur apo përdoren në/për veprimtari të ligjshme me qëllim fshehjen e origjinës së tyre.

Për të sqaruar se çdo të kuptojmë me produkt të veprës penale ose veprimtarisë kriminale të cilat i nënshtrohet procesit të “pastrimit” do ti refrohemi nenit 36 të Kodit Penal në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se: **“Konfiskimi jepet detyrimisht nga sivkata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit:të produkteve të veprës penale, ku vërfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet lisiore aë vërtetojnë tituj ose interesa të tierë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale”**. Parashikimi i bërë nga Kodi Penal përputhet me atë të bërë edhe nga Konventa e Këshillit të Europës **“Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Për Financimin e Terrorizmit”**¹⁸ në nenin 1 të të cilës është përcaktuar se: **“Produkt” nënkupton çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh niund të konsistojë në çdo pasuri.me “pasuri” nënkupton pasuri të çdo natyre, fizike ose jofizike, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe**

¹⁴ Lexo vendimin nr.327 datë 5 Dhjetor 2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹⁵ Ratifikuar me ligjin nr. 9646 datë 27.11.2006.

aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose interes mbi këtë pasuri”.

Organi i akuzës në funksion të një hetimi të plotë dhe objektiv, me qëllim zbardhjen e çështjes konkrete, ka administruar të gjitha provat e nevojshme në përputhje me rregidlat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale. Nga aktet dhe provat e administruara në dosjen e këtij procedimi penal rezulton se nga shtetasit {xxx} dhe {xxx} (apo ndonjë nga anatarët e familjes së tij) nuk janë konsumuar elementët e figurës së veprës penale **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”** parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Konkretisht, rezulton se shtetasit {xxx} dhe {xxx} kanë qene emigrante ne shtetin grek nga vitet 90' deri ne vitin 2000 dhe shumat monetare qe kane siguruar nga emigracioni i kane investuar ne pasuri te paluajtshme ne qytetin e Pogradecit, te cilat jane tjetersuar ne vazhdimesi si dhe jane marre me aktivitete private si persona fizike me object te veprimtarise “tregtim artikuj te ndryshem ” apo me object “piceri ”.

Ata kanë në pronësi 1) shtetasi {xxx} nje banese private te blere ne vitet 2004 ndersa shtetasi {xxx} nje banese private te blere ne vitin 2010 2) secili prej tyre nje automjet te llojit veture 3) shtetasi {xxx} pasuritë me nr.5/82, 5/74 dhe 5/80 të ndodhura ne ZK 8581 në qytetin e Pogradecit me sipërfaqe respektive 74.8 m2, 20.10 m2, 110.50 m2 që janë regjistruar në 11.05.2017 në zbatim të vendimit gjyqësor nr.360-123 dt 25.05.2016 dhe nr.508-155 dt.19.07.2016 të Gj.Rr.Gj Pogradec si pasuri të hipotekuara 4)_shtetasi {xxx} një llogari bankare në Credins me gjendje në depozitë shumë të shumën {xxx} lekë 5) shtetasi {xxx} nuk rezulton të ketë gjendje në llogari bankare por rezulton ti ketë dhënë hua shtetasit {xxx} shuma te ndryshme monetare.

II. 7. Shtetasit {xxx} dhe {xxx} apo familjarët e tij nuk rezultojnë persona të dënuar, të proceduar penalisht apo të dyshuar si persona të përfshirë në veprimtari apo aktivitete të jashtligjshme dhe kriminale.

II. 8. Nga analiza e informacionit të përcjellë nga bankat e nivelit të dytë të cilat operojnë në vëndin tonë për shtetasit {xxx} dhe {xxx} nuk rezultojnë transaksione të dyshimta me vlera të konsiderueshme të bëra nga persona të pa njohur apo të dyshimta nga jashtë apo brënda vëndit. Nga këta shtetas janë qarkulluar shuma monetare relativisht të larta burimi i të cilave janë të ardhurat nga emigracioni nder vite dhe shitblerja e pasurive te paluajtshme apo dhenia e huave. Nga shtetasit Gafer dhe {xxx} apo antarët e familjes së tyre nuk konstatohen transaksione të dyshimta me pasuri të luajtshme apo të pa luajtshme me qëllim fshehjen e origjinës së tyre si psh: transferimi tek personat e tretë nëpërmjet shitjes apo dhurimit . Veprimet e shitblerjes së pasurive të paluajtshme apo për dhëniet/shlyerjet e huave të kryera ndër vite nga këta shtetas janë formalizuar në akte noteriale, të cilat janë vënë në dispozicion të hetimit nga shtetasit Gafer- dhe Kastriot Mancellari. Transaksionet e kryera për këto veprime juridike janë pasqyruar ne regjistrat publikë apo në evidencat dhe sistemet e organeve dhe institucioneve përkatëse sikurse jane regjistrat noteriale, regjistrat e ZRPP-se apo regjistrave bankare. Vlen të theksohet se,shtetasit {xxx} dhe {xxx} ne rastet e shitblerjeve te pasurive te paluajtshme kane kryer pagesat perkatese ne organet publike (ZRRP) persa i perket perqindjes perkatese te tatimit te fitimit per pasurite e palujtshme qe kane shitur.

II. 11. Organi i akuzës çmon të theksojë dhe sqarojë se, vetëm fakti se një person apo

familjarët e tij kanë në pronësi të tyre pasuri të luajtshme apo të pa luajtshme të konsiderueshme nuk është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se këta persona kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”** parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal përse kohë që ata kanë kryer aktivitete të ligjshëm tregëtare ne formen e shtiblerjes-sipermarrjes se pasurive të paluajtshme apo huadhenieve të shumave monetare, nga të cilat janë siguruar shuma të konsiderueshme parash, nuk ka as prova apo indicje se ata janë të përfshirë në aktivitete apo veprimtari të jashtligjshme nga e cila janë përfituar të ardhura dhe nuk kanë kryer transaksione apo veprime të tjera me pasuri të përftuara në mënyrë të pa ligjshme me qëllim fshehjen e burimit apo origjinës së tyre.

Vepra penale e pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale presupozon pastrimin e produkteve që janë rrjedhojë e kryerjes së një vepre penale. Në rastin objekt hetimi, për shkak të arsyeve të lartpërmendura, vlerësoj se indicjet e sipërpermendura (transaksionet bankare), nuk arrijnë të kalojnë pragun e dyshimeve të arsyeshme, dhe në këto kushte, në mungesë të një vepre penale bazë që shërben për konfigurimin e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, nuk kemi të bëjmë me një vepër penale të tillë. Lidhur me veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, vepra penale bazë nga e cila gjenerojnë produktet përbëhet vetëm nga ato vepra që prodhojnë një pasurim të dukshëm e të prekshëm dhe që hyn në disponibilitetin e subjektit. Për të pasur veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, veprimet kriminale e përshkruara nga norma penale kanë për synim të përbashkët pengimin e identifikimit të prejardhjes së sendeve të dyshuara si produkte të veprimtarisë kriminale dhe ndalimin e futjes së tyre në qarkullimin civil apo mbulimin e prejardhjes. Në këto kushte, dyshimi për kryerjen e kësaj vepre penale, nuk mund të mbështetet vetëm në posedimin e sendeve apo kryerjen e transaksioneve me vlerë të lartë, pasi kërkohet një nivel më i lartë indicjesh që duhet të lidhë shumat e përdorura në aktivitete në veprimtari sipërmarrëse me dyshimin për prejardhjen dhe veprimin e kundërligjshëm, nga të cilat janë krijuar këto shuma.¹⁶

Ndodhur në kushtet, kur nuk plotësohen të treja kushtet kumulative të parashikuara nga neni 287 i Kodit Penal organi i akuzës çmon se nuk mund të vijojë me hetimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje penale përse kohë që fakti i ndodhur nuk yërbën veyrë penale.

III. 1. Bazuar në aktet dhe provat e administruara në kuadër të këtij procedimi penal vlerësohet se në rastin konkret nuk janë konsumuar elementët e figurës së veprës penale **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Për rrjedhojë hetimet në kuadër të këtij procedimi penal nuk mund të vazhdojnë sepse fakti i ndodhur nukparashikohet nga ligji si vepër penale. ”**

28. Gjykata referuar analizës së elementëve të veprës penale të parashikuara nga neni 287 i Kodit Penal, si edhe veprimtarisë hetimore, në referim të nenit 4 të K.Pr.Penale ku parashikohet se çdo dyshim për akuzën shkon në favor të të pandehurit rezulton se dyshimi që personan nën hetim të kenë kryer veprën penale për të ciën janë dyshuar, **mbeten në nivelin e dyshimit tëpambështetur nëprova.**

29. Si rrjedhojë nuk mund të provohet se shtetasit nën hetim me veprimet e tyre kanë konsumuar ndonjë formë të anës objektive të veprës penale sikurse u arsyetua më sipër, pasi

¹⁶ Vendimi nr.13 date 11.05.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

të gjitha veprimet e tyre janë kryer në kuadër të lirisë kontraktor dhe janë formalizuar përpara noterit publik. Gjithashtu nuk rezulton ndonjë e dhënë për ndonjë veprë mëmë apo veprimtari kriminale ku të ekzistojnë dyshime të bazuara në prova se janë përfshirë personat nën hetim.

30. Për sa është arsyetuar më sipër, nga ana e organit të akuzës, gjendur i bazuar dhe i drejtë ky vlerësim i provave edhe nga ana e gjykatës, kjo e fundit, (**Gjykata**) cmon se çështja duhet të pushohet sepse, nuk mund të provohet se shtetasit Gafur dhe {xxx} kanë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal

31. Në nenin 328/1 pika “dh” e K.Pr.Penale parashikohet shprehimisht se: **“Në përfundim të hetimeve paraprake... prokurori procedon me pushimin e akuzës ose çështjes kur: “...dh) del se ipandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet se e ka kryer**

Kjo dispozitë duhet të interpretohet në mënyrë sistematike me nenin 329/a të K.Pr.Penale, sipas të cilit parashikohet shprehimisht se: **“Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 328 i këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake të vendosë pushimin e akuzës ose çështjes penale”.**

32. Në analizë të kërkesës së organit të prokurorisë në raport me parashikimet ligjore të mësipërme, gjykata vlerëson se përfundimi i arritur nga organi i akuzës është i drejtë dhe për këtë arsye kjo kërkesë duhet të pranohet. Gjykata e vlerëson të drejtë veprimtarinë hetimore, të plotë dhe në analizë ligjore të dispozitës penale, **del se i pandehuri ose personi nën hetim nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet se e ka kryer.**

33. Në përfundim të arsyetimit sa sipër, gjykata çmon se, kërkesa e paraqitur nga ana e organit të akuzës, për Pushimin e çështjes penale nr.131, viti 2017, për veprën penale të **“Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”**, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, **duhet pranuar.**

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 112, 328 pg.1 pika “dh”, 329/b pg. 3 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

- Pushimin e çështjes penale nr.131, viti 2017, për veprën penale të **“Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”**, e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë
- Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditësh nga e nesërmja e komunikimit të

vendimit në Gjykatën e Apelit
Korçë.
U shpall sot në Pogradec datën

7.2018

SEKRETARE GJYQËSORE

GJYQTARE

10.0

EMONA MUÇI

AFERDITA BREGU

Shpenzime procedurale Shuma
(dv miië) lekë

2.000

Shenim: Vendimi mori forme te prere ne date 09.08.2018

i/ A M R S M A

⁹ Përpara ndryshime të bëra Kushtetutës me Ligjin Nr. 76 të vitit 2016, në nenin 148 të saj parashikohet shprehimisht se:
7. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. 2. Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë